



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit/Ured Premijera /Office of the Prime Minister

**Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur/ Vladina Komisija za Nestala Lica/ Governmental
Commission on Missing Persons**

THIRRJE PUBLIKE PËR PËRKRAHJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE TË CILAT MERREN ME ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS NË KOSOVË

Udhëzimet për Aplikantët

Data e hapjes së thirrjes: **9 gusht 2024**

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve: **29 gusht 2024**

PËRMBAJTJA:

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE TË CILAT MERREN ME ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS NË KOSOSVË.....	3
1.1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike	3
1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve	3
1.3. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe total i thirrjes ..	5
2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES	5
2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?	5
2.2. Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit	6
2.4. Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes	7
2.4.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme	7
2.4.2. Shpenzimet e tërthorta të pranueshme	7
2.4.3. Shpenzimet e papranueshme	8
3. SI TË APLIKONI.....	8
3.1. Formulari i projekt- propozimit.....	9
3.2. Përmbajtja e Formës Buxhetit	9
3.3. Ku ta dorëzoni aplikimin	9
3.4. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve	10
3.5. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje	10
4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE.....	10
4.1. Aplikacionet e pranura do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme	10
4.2. Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi	11
5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES.....	11
6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE.....	12

1. MBËSHTETJE FINANCIARE PËR PROJEKTET E OJQ-VE TË CILAT MERREN ME ÇËSHTJEN E PERSONAVE TË ZHDUKUR GJATË LUFTËS NË KOSOVË

1.1. Problemet të cilat synohet të adresohen përmes kësaj thirrje publike

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (mëtej KQPZH/ZKM), përmes kësaj Thirrje dhe në përputhje me strategjinë për realizimin e misionit dhe mandatit institucional që ka lidhur me çështjen për persona të zhdukur, përkatësisht në zbatim e misionit të tij . Misioni i KQPZH-së është : *që direkt të udhëheq, mbikëqyrë, bashkërendon dhe koordinon aktivitetet me institucione vendore, bashkëpunon me institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, dhe akterë të tjerë , në lidhje me zbardhjen e fatit të personave të zhdukur, si pasojë e luftës së viteve 1998-1999, pavarësisht përkatësisë etnike, religjionit apo statusit ushtarak apo civil .*

Programi për mbështetjen financiare publike të Organizatave të Shoqërisë Civile/Organizatave Jo-Qeveritare (më tutje OJQ-ve) në projektet dhe aktivitet e tyre kryesisht lidhur me çështjen e personave të zhdukur (zbardhjen e fatit të tyre, të drejtën e familjarëve për tu informuar lidhur me fatin e tyre) gjatë luftës në Kosovë.

Kjo strategji është një tërësi e masave konkrete që ka për qëllim mbështetjen e programeve të OJQ-ve të cilat kanë bazë në komunitet dhe synojnë të kontribuojnë /angazhohen në mbrojtjen të drejtës për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur , duke qenë pjesë aktive dhe bashkëpunuese krah për krah me institucione kompetente vendore dhe ndërkombëtare. Si dhe t'i ndihmoj/aftësoj familjarët e tyre, ashtu që t'i bëjë konkurrues, eventualisht të pajisen me njohuri specifike për të qenë të aftë për punë dhe mundësi të reja.

Kjo thirrje është bërë në formë të shpalljes publike më qëllim që të gjitha organizatave të kualifikuara t'iu jepet mundësia dhe e drejta për paraqitjen e kërkesave të tyre për financim të projektit/ve. Po ashtu ka për synim ngritjen e cilësisë së programeve - projekteve të OJQ-ve që promovojnë organizime kreative shoqërore të rehabilitimit psiko- social të familjarëve të personave të zhdukur, evokim të ngjarjeve dhe datave përkujtimore, sensibilizimit të çështjes (në forma të ndryshme), prezantimit/shkëmbimit të përvojave më të mira shoqërore, aftësimin profesional të familjarëve të personave të zhdukur, dhe të gjitha këto përmes programeve /projekteve dhe aktivitete konkrete.

1.2. Objektivat e thirrjes dhe prioritetet për ndarjen e fondeve

Objektiva e përgjithshme të kësaj Thirrje është që KQPZH -ja t'i përkrahë OJQ-të, që merren me çështjen e personave të zhdukur gjatë luftës së fundit në Kosovë pa dallim dhe pa diskriminim, e përmes kësaj-rrjedhimisht mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave themelore si dhe mbështetjen për familjarët e tyre.

Objektivat specifike të kësaj Thirrje për propozimet e OJQ-ve janë :

- *Organizimi i aktiviteteve shoqërore me qëllim të shënimit të ditëve përkujtimore të veçanta dhe të datave të rëndësishme për personat e zhdukur në Kosovë;*

- *Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi në partneritet –profesional dhe institucional në mbrojtjen e të drejtave ligjore për t'i gjetur/identifikuar/ personat e zhdukur, për t'u informuar dhe pasur qasje në informacion, si dhe të drejtat e benificuara ligjore për familjarët e personit/ve të zhdukur;*
- *Organizimi i trajnimeve me të cilat do të nxisin, zhvillojnë dhe ndërtojnë kapacitetet e pjesëtarëve të këtyre familjeve për tu bërë konkurrues në tregun e punës si dhe të pajisen me njohuritë e nevojshme për të qenë të aftë për punë dhe mundësi të reja ;*
- *Angazhimi i praktikantëve (anëtar të familjarëve të personave të zhdukur) duke investuar në aftësimin dhe zgjerimin e njohurive të tyre për profesione të caktuara;*
- *Aktivitetet që kanë të bëjnë me krijimin e një rrjeti profesional ku do të ofrohet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta të anëtarëve të grupit të rrjetit ku do të mund të ndahen informacione mbi mundësitë e punësimit ose trajnimit, si dhe për të ndihmuar njëri tjetrin në zgjidhjen e problemeve të lidhura me punën;*
- *Sensibilizimi i çështjes së personave të zhdukur gjatë luftës qoftë brenda vendit qoftë jashtë vendit ;*
- *Organizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim rehabilitimin psiko - social dhe të mbështetjes së familjeve të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.*

Projektet për mbështetje me prioritet :

- *Projektet të cilat synojnë avancimin e bashkëpunimit në mes të OJQ-ve të ndryshme si dhe bashkëpunimin me institucionet publike lokale dhe qendrore që do të reflektonin përmirësimin e situatës lidhur me personat e zhdukur dhe lehtësime të mbrojtjes të të drejtave të familjarëve të tyre;*
- *Projektet e ndryshme sensibilizuese me qëllim ngritjen e vetëdijes për këto kategori, si dhe forcimin e kapaciteteve përmes trajnimeve /aftësimeve të caktuara në kuptim të mbrojtjes së interesit publike /shoqërorë ;*
- *Organizimi i aktiviteteve që kanë për qëllim rehabilitimin psiko - social dhe tejkalimin e mërzisë të familjarëve të personave të zhdukur gjatë luftës në Kosovë.*

Kjo ftesë për propozime është dizajnuar që të bëjë thirrje për ide dhe projektet që i mbështesin objektivat e mësipërme, duke u konfirmuar me rezultatet si në vijim:

1. *Organizime të aktiviteteve shoqërore lidhur me datat përkujtimore, si dhe kurseve të rehabilitimit psiko-social të familjarëve të personave të zhdukur;*
2. *Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi në partneritet –profesional në mbrojtjen e të drejtave ligjore për t'i gjetur/identifikuar/verifikuar, për t'u informuar dhe pasur qasje në informacion, si dhe të drejtat e benificuara ligjore për familjarët e personit/ve të zhdukur;*
3. *Trajnime të bashkë - koordinuara për fusha të ndryshme të profesionale, si dhe mbështetja për kryerjen e praktikave profesionale për praktikantët në institucione dhe në biznese ;*
4. *Aktivitete sensibilizuese (ekspozita , konferenca, qoftë në nivel nacional apo ndërkombëtarë);*
5. *Aktivitete të ngjashme që ndikojnë në mirëqenien e familjarëve të personave të zhdukur, përmes formave të aftësimit dhe trajnimit profesional.*

Përveç këtyre, idetë/synimet e projektit mund të reflektojnë një ose me shumë nga rezultate e mëposhtme:

- **Mbrojtje dhe avancime** të të drejtave dhe beneficionëve tek autoritet komunale/qendrore në zbatimin e kornizës ligjore dhe politikave sociale, në veçanti për sa i përket përkujdesjes dhe punësimit për këtë kategori sipas ligjit për persona të zhdukur ;
- **Hartimin/Zbatimin e shtuar të strategjive** dhe veprimeve që adresojnë apo ndikojnë tek autoritete te caktuar në zbardhjen e fatit të personave të zhdukur.
- **Ngritjen e kualitetit të jetës** të pjesëtarëve të familjeve të kësaj kategorie, për mes projekteve të caktuar.
- **Adresimi i problemeve specifike të OJQ -ve dhe familjarëve** të kategorisë së familjarëve të personave të zhdukur;
- **Zhvillimin e mundësive ekonomike** për pjesëtarët-familjarët të kësaj kategorie, respektivisht trajnimi/ aftësimi i tyre në gjenerimin e të hyrave ekonomike/familjare.

Mbështetje financiare publike do të kenë:

Të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile/OJQ –të në Kosovë që janë të regjistruara, sipas ligjit dhe kanë bazë në komunitet, dhe të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës prej së paku 2 (dy) vite para datës së publikimit të thirrjes publike, si dhe dëshmojnë veprimtarinë/angazhimin e tyre në çështjen e personave të zhdukur.

1.3. Vlera e planifikuar e mbështetjes financiare për projektet dhe total i thirrjes

1. Për mbështetje financiare publike për projektet/programet sipas kësaj Thirrje publike është paraparë shuma në dispozicion prej **60,000.00 (gjashtëdhjetë mijë) euro**.
2. Shuma minimale e mbështetjes financiare për çdo projekt individual është **2,000.00 (dy mijë) euro**, ndërsa shuma maksimale për një projekt individual është **4,000.00 (katër mijë) euro**. Ndërsa shuma minimale për organizatat në partneritet me së paku dy OJQ është **4,000.00 (katër mijë) euro**, si dhe në raste të partneritetit të dy e më shumë organizatave shuma e mbështetjes maksimale është **8,000.00 (tetë mijë) euro**.

2. KUSHTET FORMALE TË THIRRJES

2.1. Aplikuesit e pranueshëm: kush mund të aplikoj?

1. Të gjitha OJQ-të aplikuese që janë të regjistruara në pajtim me Ligjin për Lirinë e Asocimit në Organizata Jo-Qeveritare (OJQ-ja aplikuese duhet të dërgoj kopjen e **certifikatës së regjistrimit** me rastin e aplikimit);
2. Të ketë zotësi juridike, financiare dhe operationale për zbatimin e projektit;

3. OJQ-të/ shoqatat, aktiviteti dhe **veprimtaria e tyre është indikative/e fokusuar për persona të zhdukur**, (për kujdesin si dhe mbështetjen për familjarët e tyre).
 4. Të ketë kryer të gjitha **detyrimet tatimore dhe kontributet tjera të detyrueshme** në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
 5. **Të mos jetë në proces falimentimi**, shuarje, në procedura të mbylljes së detyrueshme apo likuidimit;
 6. Të mos ketë shkëlur kushtet e parashikuara të përdorimit të fondeve publike.
- Një aplikant mund të paraqesë vetëm një kërkesë për aplikim.

2.2. Partnerët e pranueshëm në zbatimin e projektit/programit

1. Aplikuesit që veprojnë në partneritet me të paktën një OJQ, e cila ushtron aktivitetin e njëjtë;
2. Partnerët duhet të përmbushin të gjitha kriteret e përshtatshmërisë (që zbatohet për aplikuesit), të specifikuar në pikën 2.1, të këtij udhëzuesi ;
3. Me rastin e aplikimit, aplikuesi duhet të ketë **arritur marrëveshje të partneritetit me OJQ-në partnere**. Për këtë qëllim duhet nënshkruar një deklaratë e partneritetit, e cila duhet të dorëzohet një kopje origjinale të/e nënshkruar nga secili partner në projekt.

2.3. Aktivitetet e pranueshme që do të financohen dhe kohëzgjatja

1. Kohëzgjatja e planifikuar e projekteve është më së shumti katër muaj pas përfitimit.
2. Aktivitetet e projektit duhet të realizohen brenda territorit të Kosovës (përfshirë për projektet sensibilizuese)
3. **Llojet kryesore të projekteve - Aktiviteteve që do të financohen përfshijnë:**
 - Aktivitete që synojnë avancimin e politikave qeveritare në dinamizmin e zbardhjes së fatit të personave të zhdukur si dhe mbrojtjen e të drejtave të familjarëve të kësaj kategorie;
 - Kërkesat nga OJQ-të për organizime të aktiviteteve shoqërore lidhur me datat përkujtimore, si dhe kurseve të rehabilitimit psiko-social të familjarëve të personave të zhdukur;
 - Trajnime të bashkë - koordinuara për fusha të ndryshme të profesionale, si dhe mbështetja për kryerjen e praktikave profesionale për praktikantët në institucione dhe në biznese ;
 - Adresimi i problemeve specifike të OJQ -ve dhe familjarëve të kësaj kategorie;
 - Rrjetëzimi dhe konsulta të bashkëpunimi në partneritet -profesional në mbrojtjen e të drejtave ligjore për t'i gjetur/identifikuar/verifikuar, për t'u informuar dhe pasur qasje në informacion, si dhe të drejtat/benificionet ligjore shtetërore për familjarët e personave të zhdukur;
 - Aktivitetet sensibilizuese të çështjes së personave të zhdukur.
4. **Llojet e mëposhtme të aktiviteteve nuk janë të pranueshme për financim:**
 - Aktivitete që nuk zhvillohen në Kosovë (me përjashtim ato sensibilizuese);
 - Aktivitetet që nuk përfshijnë çështjen e personave të zhdukur apo familjarëve të tyre;
 - Aktivitete që përmbajnë çfarëdo lloj diskriminim të ndaluar me ligj.

2.4. Shpenzimet e pranueshme që do të financohen përmes thirrjes

Përmes kësaj thirrje publike, mund të financohen vetëm kostot reale dhe të pranueshme për realizimin e aktiviteteve të projektit në lartësinë reale të këtyre shpenzimeve, në dhe për periudhën kohore të specifikuar me këtë udhëzues.

2.4.1. Shpenzimet e drejtpërdrejta të pranueshme

Shpenzimet e kostove të pranueshme direkte përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura me zbatimin e disa aktiviteteve të projektit ose të programit të propozuar, të përshkruara si më poshtë:

- Shpenzimet rreth organizimit të aktiviteteve (Organizimi i trajnimeve duhet të identifikohet lloji dhe çmimi i secilit shërbim);
- Materiali shpenzues;
- Sigurimi i sallave, shpenzimet e zërimit, ndriçimit, përkthimit etj;
- Shpenzimet e pagave dhe pagesave për menaxherët e projektit/programit, të kontraktorëve të projektit nga organizatat dhe/ose partnerët e jashtëm të përfshirë në projekt (kontratat e bashkëpunimit, kontratat e punësimit), duke specifikuar emrin e personave të angazhuar, kompetencat e tyre profesionale, numrin e muajve të angazhimit dhe shumën mujore bruto të kompensimit;
- Transporti (shpenzimet për transportin dhe akomodimin, aty ku është e nevojshme duke e specifikuar numrin e njerëzve, destinacionin, shpeshtësinë dhe qëllimin e udhëtimit dhe llojin e transportit publik, llojin e akomodimit dhe numrin e netëve);
- Pjesëmarrjen në punëtori apo pjesëmarrje në trajnime të caktuara;
- Shpenzimet e udhëtimit (p.sh., mëditjet);
- Shpenzimet e komunikimit (shpenzimet e telefonit, internetit), këto shpenzime duhet të jenë të përcaktuara(caktuara);
- Shërbime grafike (shërbimet për shtypjen e fletushkave, broshurave, revistave, duke specifikuar llojin e qëllimin e shërbimit, sasinë, çmimin e njësisë, etj materiale te projektit përkatës) ;
- Kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e aktiviteteve të projektit apo programit (shpenzimet e përfaqësimit që kanë të bëjnë me organizimin e aktiviteteve të projektit/programit, duke treguar qëllimin dhe numrin e pritshëm të pjesëmarrësve, etj);

2.4.2. Shpenzimet e tërthorta të pranueshme

Përveç shpenzime të pranueshme direkte, në kuadër të kësaj thirrje do të pranohen edhe kostot indirekte, që përfshijnë kostot që nuk janë të lidhura direkt me zbatimin e projektit ose programit, por janë kosto që në mënyrë të tërthortë kontribuojë në arritjen e objektivave të projektit (edhe këto duhet të specifikohen dhe të shpjegohen).

2.4.3. Shpenzimet e papranueshme

Shpenzimet e papranueshme përfshijnë:

- Investimet në kapital apo kredi për investime, fonde të garancisë;
- Kostot e blerjes së pajisjeve, orendive, dhe punëve të vogla ndërtimore në qoftë se kalojnë vlerën prej 10% të totalit të kostove të pranueshme të projektit;
- Shpenzimet e interesit për borxhin;
- Gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet e procedurave gjyqësore;
- Pagesa e bonusëve për punonjësit;
- Detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive, tarifat për transferet financiare dhe tarifat e tjera krejtësisht të një natyre financiare;
- Kostot që tashmë janë të financuara nga burime publike apo shpenzime në periudhën e projektit të financuar nga burime të tjera;
- Blerja e pajisjeve të përdorura, makineri dhe orendi etj;
- Kostot që nuk mbulohen nga marrëveshja (kontrata me ofruesin e mbështetjes financiare);
- Donacionet bamirëse;
- Kredi për organizata të tjera apo individ;
- Kostot e tjera që nuk janë të lidhura direkt me përmbajtjen dhe objektivat e projektit;

3. SI TË APLIKONI

Aplikimi i OJQ-ve/Shoqatave do të konsiderohet i plotë nëse përmban të gjitha format e aplikimit dhe anekset e detyrueshme siç kërkohet në thirrjen publike dhe dokumentacionin e thirrjes si në vijim:

1. Formulari i projekt-propozimit (shkarkohet online);
2. Formulari i propozim buxhetit (shkarkohet online);
3. Forma e deklaratës për financim të dyfishtë (shkarkohet online);
4. Formulari i deklaratës së partneritetit ,nëse ka partneritet (shkarkohet online);
5. Forma e deklaramit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit (shkarkohet online);
6. Deklaratë mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktorët , nëse ka (formulari shkarkohet online) ;
7. Kopja e Certifikatës së regjistrimit të OJQ-së dhe Numrit Fiskal ;
8. Kopja e Letërnjoftimit (e përfaqësuesit të autorizuar) dhe konfirmimin nga banka për xhironlogarinë e aplikuesit ;
9. Dëshminë e penalitetit nga Gjykata për menaxherët e projekteve;
10. Certifikatë nga Administrata Tatimore e Kosovës në lidhje me gjendjen e borxhit publik të aplikuesit dhe partnerëve që vërteton se organizata nuk ka borxh, dhe në rast se ka borxh publik, duhet të paguhen para nënshkrimit të kontratës. Certifikata duhet të jetë lëshuar brenda periudhës që nga data e hapjes së thirrjes publike.

Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) i cili duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me dokumentacionin e dërguar në formë fizike.

Formularët mund të shkarkohen në: www.kryeministri.rks-gov.net

3.1. Formulari i projekt- propozimit

Plotësimi i formularit të projekt propozimit (gjendet në aplikacionin online) është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. Ajo përmban të dhëna në lidhje me aplikuesin dhe partnerët si dhe të dhëna mbi përmbajtjen e projektit/programit për të cilin kërkohet financim nga burimet publike.

Në rast se në formën e dorëzuar mungojnë të dhënat në lidhje me përmbajtjen e projektit, aplikimi nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. (*Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë*).

3.2. Përmbajtja e Formës Buxhetit

Formulari i propozim buxhetit është pjesë e dokumentacionit të detyrueshëm. **Duhet** të përmbaj informacion për të gjitha shpenzimet direkte dhe indirekte të projektit/programit të propozuar për financim.

Nëse forma e buxhetit nuk është e plotësuar në tërësi, në formën përkatëse, nuk do të merret në konsideratë.

Forma është e nevojshme të plotësohet me kompjuter. (*Nëse forma është plotësuar me dorë nuk do të merret në konsideratë*).

3.3. Ku ta dorëzoni aplikimin

Format e detyrueshme dhe dokumentacioni i kërkuar duhet të dërgohen në formë fizike, të shtypur (në një original) dhe në formë elektronike (në CD). Format e detyrueshme duhet të jenë të nënshkruara nga përfaqësuesi i autorizuar dhe të vulosura me vulën zyrtare të organizatës. Dokumentacioni në formë elektronike (në CD) duhet të ketë të njëjtën përmbajtje, pra të jetë identik me versionin e shtypur. Dokumentacioni i shtypur dhe në CD duhet të vendosen në një zarf të mbyllur.

Aplikimi original duhet të dërgohet me postë ose në person dhe në pjesën e jashtme të zarfit duhet të shënohet titulli i thirrjes publike nga kategoria që aplikoni, së bashku me emrin e plotë dhe adresën e aplikuesit dhe me shënimin "**Të mos të hapet para takimit të Komisionit Vlerësues**".

Aplikacionet duhet të dërgohen në adresën e mëposhtme:

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur/Zyra e Kryeministrit

Sheshi "Nëna Terezë", pa nr. Prishtinë, kati.VI, Zyra nr. 604

"Të mos hapet para mbledhjes së Komisionit Vlerësues"

3.4. Afati i fundit për dërgimin e aplikacioneve

Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë pune nga data e shpalljes së thirrjes (09.08.2024) dhe afati i mbylljes së thirrjes është me datë 29.08.2024 ora 16:00.

Në rast të aplikimit përmes postës, kërkesa konsiderohet që është dorëzuar brenda periudhës së thirrjes nëse vula pranuese tregon se është marrë në postë deri në fund të datës së thirrjes - si afati i fundit për dorëzimin. Në rast se kërkesa është paraqitur personalisht në Zyrë, aplikantit do ti lëshohet një vërtetim se aplikacioni është pranuar brenda periudhës së konkursit.

Komisioni Qeveritar për Persona të Zhdukur për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë aplikantëve të mundshëm, nuk do të japë një mendim paraprak për provueshmërinë e aplikantëve, për partnerët, veprimet apo shpenzimet e përmendura në kërkesë.

Të gjitha aplikacionet e dërguara pas afatit nuk do të merren parasysh.

3.5. Si të kontaktoni nëse keni ndonjë pyetje

Të gjitha pyetjet në lidhje me thirrjen mund të bëhen vetëm në mënyrë elektronike, duke i dërguar si kërkesë në adresën e mëposhtme: njesia.kqpzh@rks-gov.net, jo më vonë se 5 ditë pune para mbylljes së thirrjes.

4. VLERËSIMI DHE NDARJA E FONDEVE

4.1. Aplikacionet e pranuar do të kalojnë nëpër procedurën e mëposhtme

4.1.1 Ofruesi i mbështetjes themelon një komision vlerësues të përbërë nga 5 anëtarë - zyrtar të institucionit dhe ekspert tjerë të jashtëm, i cili ka për detyrë të vlerësojë aplikacionet nëse i plotësojnë kushtet formale të thirrjes publike.

Pas kontrollimit të të gjitha aplikacioneve të pranuar, komisioni do të përgatis një listë të gjitha aplikantëve që i plotësojnë kushtet për tu vlerësuar përmbajtja e projekteve të tyre, dhe një listë të aplikantëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara të konkurrencës. Listat do të publikohen përmes sistemit online.

KPQZH do të njoftojë me shkrim të gjithë aplikantët të cilët nuk i plotësojnë kërkesat dhe arsyet e refuzimit të aplikimit të tyre.

4.1.2 Në fazën e dytë do të bëhet vlerësimi i përmbajtjes së aplikimeve nga ana e Komisionit vlerësues i përbërë nga 5 anëtarë. Çdo aplikacion i pranuar do të vlerësohet në bazë të formularit të vlerësimit.

Lista e përkohshme e projekteve/programeve përfituese të përzgjedhura për financim - bëhet në bazë të vlerësimit të aplikacioneve të cilat i kanë plotësuar kushtet e parashikuara të thirrjes, Komisioni do të hartojë një listë të përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura, sipas

pikëve që ata kanë marrë në procesin e vlerësimit. Shuma totale e kostos së projekteve të radhitura në listën e përkohshme nuk do të kalojë shumën totale të ofruar për financim përmes thirrjes publike.

Krahas listës së përkohshme, bazuar në pikat që janë bërë gjatë vlerësimit, Komisioni do të hartojë edhe listën rezervë të projekteve/programeve.

4.2. Dokumentacion shtesë dhe Kontraktimi

Për të shmangur shpenzimet e panevojshme shtesë kur të aplikoni, KQPZH do të kërkojë dokumentacion shtesë vetëm nga ata aplikantë të cilët, në bazë të procesit të vlerësimit të aplikacioneve, ka hyrë në listën e përkohshme të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Para nënshkrimit përfundimtar të kontratës, dhe në bazë të vlerësimit të Komisionit, ofruesi mund të kërkojë shqyrtimin e formës së buxhetit për kostot e vlerësuara që korrespondojnë me shpenzimet aktuale në lidhje me aktivitetet e propozuara.

Komisioni vlerësues do të bëjë kontrollimin e dokumentacionit shtesë.

Nëse aplikuesi nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar shtesë brenda kohës së *aktuar*, aplikimi do të refuzohet.

Nëse pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse vendoset se disa nga aplikuesit nuk i plotësojnë kushtet e kërkuara të thirrjes publike, nuk do të merret në konsideratë për nënshkrim të kontratës.

Në raste të tilla, projektet nga lista rezervë do të aktivizohen nëse, pas kontrollimit të dokumenteve mbështetëse dhe pasi të konstatohet nga institucioni se ka mjete të mjaftueshme për të kontraktuar projekte të tjera.

Pas kontrollit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni do të propozojë listën përfundimtare të projekteve/programeve të përzgjedhura për financim.

Njoftimi i aplikuesve - Të gjithë aplikantët, aplikimet e të cilëve kanë hyrë në procesin e vlerësimit do të jenë të informuar me kohë në lidhje me vendimin për ndarjen e projekteve.

5. KALENDARI INDIKATIV I REALIZIMIT TË THIRRJES

Fazat e procedurës së thirrjes:

1. Afati i fundit për aplikimet: **29.08.2024**
2. Afati i fundit për dërgimin e pyetjeve në lidhje me thirrjen: **23.08.2024**
3. Afati i fundit për dërgimin e përgjigjeve për pyetjet që lidhen me thirrjen: **26.08.2024**
4. Afati i fundit për verifikimin e përmbushjes së kriterëve procedurale dhe njoftimit të palëve: **05.09.2024**
5. Afati i fundit për vlerësimin e aplikimeve në mënyrë përmbajtjesore: **09.09.2024**
6. Afati i fundit për kërkesën për dorëzimin e dokumenteve shtesë: **13.09.2024**
7. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar: **17.09.2024**

8. Afati i fundit për publikimin e vendimit për ndarjen e fondeve publike dhe njoftimi i aplikantëve: **24.09.2024**
9. Afati për kontraktim: **01.10 deri 04.10.2024. (përjashtimisht kur ekzistojnë arsyet e qëndrueshëm, afati për kontraktim mund të shtyhet konform nenit 22 të Rregullores MF-NR-04/2017).**

KQPZH -ja ka të drejtë të përditësoj kalendarin indikativ. Duhet të dini (përcillni) se çdo ndryshim në kalendarin indikativ do të publikohet në faqen e internetit të mëposhtme <https://kryeministri.rks-gov.net>

6. LISTA E DOKUMENTEVE TË THIRRJES PUBLIKE

FORMULARËT

1. Thirrja publike ;
2. Udhëzuesi i thirrjes publike(shkarkohet online);
3. Formulari / Aplikacioni i projekt-propozimit (shkarkohet online);
4. Formulari i propozim buxhetit (shkarkohet online);
5. Forma e deklaratës për financim të dyfishte (shkarkohet online);
6. Formulari i deklaratës së partneritetit, nëse ka partneritet (shkarkohet online);
7. Forma e deklarimit të projekteve apo programeve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike të financimit, nëse ka (formulari shkarkohet online);
8. Deklarata mbi aktivitetet e përshkruara për kontraktorët, nëse ka (shkarkohet online) ;
9. Formulari i raportit narrativ – përshkrues ;
10. Formulari i raportit financiar ;

Formularët mund të shkarkohen në: <https://kryeministri.rks-gov.net/konkurse-njoftime-dhe-shpallje/>

Vërejtje/Kujdes: Të gjitha aplikimet të cilat nuk do të kenë dokumentacionin e kompletuar nuk do të merren parasysh